



EUROPEAN  
PUBLIC  
PROSECUTOR'S  
OFFICE



### **Marrëveshje Pune**

**për bashkëpunimin ndërmjet Zyrës së Prokurorit Publik Evropian  
dhe Strukturës së Posaçme kundër Korrupsionit dhe Krimit të Organizuar të Republikës së  
Shqipërisë**

**Marrëveshje Pune**  
**për bashkëpunimin ndërmjet Zyrës së Prokurorit Publik Evropian**  
**dhe Strukturës së Posaçme kundër Korrupsionit dhe Krimin të Organizuar të Republikës së**  
**Shqipërisë**

Zyra e Prokurorit Publik Evropian ("ZPPE"), në vijim referuar si "ZPPE", dhe Struktura e Posaçme kundër Korrupsionit dhe Krimin të Organizuar në Republikën e Shqipërisë, në vijim referuar si ("SPAK"), së bashku të referuara si "palët",

Duke pasur parasysh dispozitat e Rregullores së Këshillit (BE) 2017/1939 të datës 12 tetor 2017 për zbatimin e bashkëpunimit të zgjeruar për krijimin e ZPPE, në vijim referuar si "Rregullorja ZPPE", dhe në veçanti nenet 99 dhe 104 të tij,

Duke pasur parasysh dispozitat e Kushtetutës të Republikës së Shqipërisë, në vijim referuar si "Kushtetuta e Shqipërisë" dhe Ligjit nr. 95/2016, "Për Organizimin dhe Funksionimin e Institucioneve për të Luftuar Korrupsionin dhe Krimin e Organizuar", në vijim referuar si "Ligji nr.95/2016" për përfaqësimin e SPAK në marrëdhënie me të tretët dhe ndihmën e ndërsjelltë në çështjet penale të juridiksionit të posaçëm, dhe në veçanti neni 4, neni 15, pika 2 shkronja "a" dhe neni 22 të Ligjit nr. 95/2016,

Duke marrë parasysh vullnetin e Palëve për të vendosur një bashkëpunim të ngushtë me qëllim mbrojtjen nga mjetet hetimore dhe prokuroriale të interesave financiare të Bashkimit Evropian dhe të Republikës së Shqipërisë,

Duke marrë parasysh kompetencën e veçantë të SPAK-ut për hetimin, ndjekjen penale dhe vënien para gjykimit të autorëve të korrupsionit dhe krimin të organizuar dhe kompetencën e ZPPE-së për të hetuar, ndjekur penalisht dhe sjellë para gjykimit autorët e krimeve kundër interesave financiare të Bashkimit Evropian,

Me synimin për të lehtësuar bashkëpunimin dhe shkëmbimin e informacionit ndërmjet tyre për të garantuar hetim dhe ndjekje penale efektive, në përputhje të plotë me Kartën e të Drejtave Themelore të Bashkimit Evropian, dhe vënien para drejtësisë pa vonesa të panevojshme e të gjithë personave që dyshohen ose akuzohen për kryerjen e krimeve kundër buxhetit të BE-së,

KANË RËNË DAKORD SI MË POSHTË:

## **Kapitulli I**

### **Dispozitat e përgjithshme**

#### **Neni 1**

##### **Qëllimi**

- (1) Qëllimi i kësaj Marrëveshje Pune është të lehtësojë bashkëpunimin gjyqësor në çështjet penale dhe shkëmbimin e informacionit ndërmjet palëve.
- (2) Palët do të shkëmbejnë informacion strategjik dhe do të krijojnë forma të tjera të bashkëpunimit operacional dhe institucional në përputhje me dispozitat e kësaj Marrëveshjeje Pune.
- (3) Për mbledhjen e provave ose sigurimin e ekstradimit të personave të kërkuar, si dhe për forma të tjera të bashkëpunimit gjyqësor ndërmjet tyre, Palët do të zbatojnë instrumentet përkatëse shumëpalëshe për bashkëpunimin gjyqësor në çështjet penale, duke përfshirë, por pa u kufizuar, Konventën Evropiane për ndihmën e ndërsjellë në çështjet penale dhe Protokollet e saj shtesë, si dhe Konventën e Kombeve të Bashkuara kundër krimit të organizuar ndërkombëtar dhe Konventën e Kombeve të Bashkuara kundër korrupsionit.

#### **Neni 2**

##### **Fushëveprimi**

Palët do të bashkëpunojnë në të gjitha fushat e përmendura në këtë Marrëveshje Pune në përputhje me kuadrin ligjor në fuqi.

#### **Neni 3**

##### **Përkufizimet**

Për qëllimet e kësaj Marrëveshjeje Pune:

- a) 'Prokuror Evropian' nënkupton personelin e ZPPE-së të përmendur në nenet 16 dhe 96(1) të Rregullores ZPPE;
- b) 'Prokuror i Deleguar Evropian' nënkupton personelin e ZPPE-së të përmendur në nenet 17 dhe 96(6) të Rregullores ZPPE;
- c) "Personel ZPPE" nënkupton personelin dhe personat e tjerë të përmendur në nenin 2 (4) të Rregullores së ZPPE-së;

- d) "Të dhënat personale" nënkupton çdo informacion në lidhje me një person fizik të identifikuar ose të identifikueshëm ("subjekt i të dhënave"); një person fizik i identifikueshëm është ai që mund të identifikohet, drejtpërdrejt ose tërthorazi, veçanërisht duke iu referuar një identifikuesi si emri, një numër identifikimi, të dhënat e vendndodhjes, një identifikues në internet ose një apo më shumë faktorë specifikë të identitetit fizik, fiziologjik, gjenetik, mendor, ekonomik, kulturor ose social të atij personi fizik; dhe
- e) "Informacion" nënkupton të dhëna personale dhe jopersonale.

## **Kapitulli II**

### **Bashkëpunimi operativ**

#### **Neni 4**

##### **Bashkëpunimi për mbledhjen e provave**

Palët do t'i ofrojnë njëra-tjetrës shkallën më të gjerë të bashkëpunimit për mbledhjen e provave, në përputhje me dispozitat e Konventës Evropiane për ndihmën e ndërsjellë në çështjet penale, Strasburg, 20 prill 1959, dhe Protokollin e saj shtesë.

#### **Neni 5**

##### **Sekuestrimi i aseteve**

Palët do të bashkëpunojnë në fushën e sekuestrimit të aseteve në përputhje me instrumentet ligjore shumëpalëshe në fuqi, duke përfshirë Konventën e Këshillit të Evropës për Pastrimin, Kërkimin, Sekuestrimin dhe Konfiskimin e të Ardhurave nga Krimi dhe për Financimin e Terrorizmit, Varshavë, 16 maj 2005.

#### **Neni 6**

##### **Skuadrat e përbashkëta hetimore**

- (1) Palët mund të bashkëpunojnë për ngritjen e skuadrave të përbashkëta hetimore në rastet që do të jenë nën kompetencën e ZPPE-së.
- (2) Për ngritjen e një grupi të përbashkët hetimor, Palët do të lidhin marrëveshje specifike, në përputhje me Protokollin e Dytë shtesë të Konventës Evropiane për ndihmën e ndërsjellë në çështjet penale.

#### **Neni 7**

##### **Ekstradimi**

Palët pranojnë se kur është e nevojshme që ZPPE të kërkojë ekstradimin e një personi të kërkuar, Prokurori i deleguar Evropian që merret me këtë mund t'i kërkojë autoritetit kompetent të Shtetit të

tij/saj Anëtar të lëshojë një kërkesë ekstradimi në përputhje me Konventën Evropiane për ekstradimin, Paris, 13 dhjetor 1957, dhe Protokollet e tij shtesë.

### **Kapitulli III**

#### **Bashkëpunimi strategjik dhe çështjet institucionale**

##### **Neni 8**

##### **Shkëmbimi i informacionit strategjik dhe informacione të tjera**

- (1) Palët mund të shkëmbejnë çdo informacion strategjik dhe informacion tjetër jo-operativ në fushat brenda kompetencës së tyre.
- (2) Informacioni i përmendur në paragrafin 1 nuk duhet të përmbajë të dhëna personale.

##### **Neni 9**

##### **Komandimi i oficerëve ndërlidhës në ZPPE**

- (1) Për të lehtësuar zbatimin e kësaj Marrëveshjeje Pune dhe veçanërisht për të nxitur bashkëpunimin operacional ndërmjet Palëve, SPAK mund të komandojë një oficer ndërlidhës në selinë e ZPPE-së në Luksemburg.
- (2) ZPPE do të sigurojë një zyrë, pajisje teknike dhe mbështetjen e nevojshme logjistike për oficerin ndërlidhës të komanduar në selinë e saj. SPAK do të mbulojë të gjitha kostot e tjera të komandimit.
- (3) Palët do të bien dakord për Marrëveshjet specifike të Punës në lidhje me komandimin e oficerit ndërlidhës përmes një shkëmbimi letrash.

##### **Neni 10**

##### **Pikat e Kontaktit të ZPPE në SPAK**

Në përputhje me nenin 104(2) të Rregullores së ZPPE, Palët bien dakord që ZPPE të ketë si pikë kontakti të saj në SPAK, Sektorin e Bashkëpunimit Ndërkombëtar dhe Ndërlidhjes për Hetimet e Përbashkëta.

##### **Neni 11**

### **Takime dhe aktivitete të tjera**

- (1) Palët do të organizojnë takime të nivelit të lartë ndërmjet Kryeprokurorit Evropian dhe Drejtuesit të Prokurorisë së Posaçme, si dhe takime teknike në të dy nivelet operacionale dhe administrative.
- (2) Palët mund të bashkëpunojnë në organizimin e sesioneve trajnuese për çështje me interes të përbashkët dhe mund të ftojnë njëra-tjetrën në seminare, takime pune, konferenca dhe aktivitete të tjera të ngjashme që janë në mënyrë reciproke të rëndësishme.

### **Neni 12**

#### **Mbështetja teknike e ofruar nga ZPPE**

Me kërkesë, ZPPE mund të mbështesë SPAK-un në ushtrimin e funksioneve të saj, veçanërisht me njohuritë dhe shkëmbimin e praktikave më të mira në hetimin dhe ndjekjen penale të krimeve financiare dhe korrupsionit.

### **Neni 13**

#### **Mjetet dhe kanalet e komunikimit**

- (1) Palët do të komunikojnë me çdo mjet me anë të të cilit mund të prodhohet një procesverbal me shkrim, duke përfshirë mjetet e sigurta të komunikimit elektronik.
- (2) Në nivel operacional, Palët do të bashkëpunojnë drejtpërdrejt. Kërkesat për ndihmë ose vendime gjyqësore drejtuar ZPPE-së i dërgohen Zyrës Qendrore.
- (3) Në nivel strategjik dhe menaxherial, Palët do të komunikojnë nëpërmjet Kryeprokurorit Evropian dhe Drejtuesit të Prokurorisë së Posaçme.

## **Kapitulli IV**

### **Përpunimi i të dhënave personale, siguria dhe përgjegjësia e të dhënave**

### **Neni 14**

#### **Shkëmbimi i të dhënave personale**

Çdo shkëmbim i të dhënave personale ndërmjet Palëve do të bëhet në përputhje me kuadrin ligjor përkatës në fuqi të Bashkimit Evropian dhe atë Shqiptar.

### **Neni 15**

#### **Dispozitat e përgjithshme**

1. Në lidhje me të dhënat personale të shkëmbyera në përputhje me këtë Marrëveshje Pune, Palët do të sigurojnë që:
  - a) të dhënat personale përpunohen në mënyrë të drejtë;
  - b) të dhënat personale të siguruara janë të përshtatshme, relevante dhe jo të tepruara në lidhje me qëllimin specifik të kërkesës ose transferimit;
  - c) të dhënat personale ruhen vetëm për aq kohë sa është e nevojshme për qëllimin për të cilin të dhënat janë siguruar ose përpunuar më tej në përputhje me këtë Marrëveshje Pune. Një nevojë e tillë duhet të rishikohet jo më vonë se në përputhje me kuadrin ligjor përkatës të Palëve; dhe
  - d) asnjë e dhënë personale nuk transmetohet pa qëllim.

## **Neni 16**

### **Transmetimi i kategorive të veçanta të të dhënave personale**

1. Të dhënat personale që zbulojnë origjinën racore ose etnike, opinionet politike ose besimet fetare ose të tjera, anëtarësimin në sindikata ose ato në lidhje me shëndetin dhe jetën seksuale do të ndalohen, përveç rasteve kur ato janë rreptësisht të nevojshme për një qëllim të përcaktuar në nenin 1 të kësaj Marrëveshje Pune.
2. Palët do të marrin masat e duhura mbrojtëse, veçanërisht masat e duhura teknike dhe organizative të sigurisë, për të respektuar ndjeshmërinë e veçantë të kategorive të të dhënave personale të përmendura në paragrafin 1 të këtij neni.

## **Neni 17**

### **Të drejtat e subjektit të të dhënave dhe kërkesat për Qasje në Publik**

1. Në përputhje me legjislacionin përkatës në fuqi, individët zotërojnë një sërë të drejtash në lidhje me përpunimin e të dhënave të tyre personale të shkëmbyera sipas kësaj Marrëveshjeje Pune nga Palët. Këto të drejta ushtrohen në përputhje me ligjin në fuqi për Palën të cilës i është paraqitur kërkesa.
2. Pala së cilës i është paraqitur kërkesa do t'i japë palës tjetër mundësinë për të shprehur mendimin e saj, veçanërisht përpara se t'i jepet çdo akses në subjektin e të dhënave pas një kërkesë të tillë. Palët informojnë njëra-tjetrën për vendimin përfundimtar të marrë në lidhje me kërkesën që kanë marrë.
3. Kërkesat për qasje publike në dokumentet e shkëmbyera sipas kësaj Marrëveshjeje Pune do t'i nënshtrohen të njëjtës kërkesë konsultimi sipas paragrafit 2 të këtij neni, duke përfshirë njoftimin për veprimin përfundimtar të ndërmarrë.
4. Ky nen është pa paragjykim ndaj çdo të drejte që një individ mund të ketë sipas ligjit në fuqi për Palën transmetuese për të kërkuar lëshimin e informacionit nga ajo Palë, ose lehtësime të tjera të

përshtatshme. Gjithashtu në raste të tilla kur kjo ka të bëjë me informacionin e shkëmbyer sipas kësaj Marrëveshjeje Pune, detyrimet sipas paragrafit 2 do të zbatohen në përputhje me rrethanat.

## **Neni 18**

### **Detyrimet e njoftimit**

1. Nëse një Palë merr dijeni ose nëpërmjet kërkesës së subjektit të të dhënave, përmes njoftimit nga pala transmetuese ose nëpërmjet ndonjë mënyre tjetër, se informacioni që ajo ka marrë apo transmetuar tek Pala tjetër nuk është ose mund të mos jetë i saktë, ose nuk duhet të ishte transmetuar, ai do të marrë të gjitha masat e duhura për t'u mbrojtur nga mbështetja e gabuar në një informacion të tillë, i cili mund të përfshijë plotësimin, fshirjen ose korrigjimin e këtij informacioni, duke përfshirë informimin e Palës tjetër, e cila do të veprojë në përputhje me rrethanat.
2. Në rast të shkeljes së të dhënave personale, Palët do të informojnë njëra-tjetrën kur bëhet fjalë për të dhënat personale të shkëmbyera sipas kësaj Marrëveshjeje Pune.

## **Neni 19**

### **Siguria e të dhënave**

Palët sigurojnë që masat e nevojshme teknike dhe organizative të përdoren për të mbrojtur të dhënat personale të marra sipas kësaj Marrëveshjeje Pune ndaj shkatërrimit aksidental ose të paligjshëm, humbjes aksidentale ose zbulimit të paautorizuar, ndryshimit, aksesit ose çdo forme të paautorizuar të përpunimit. Palët sigurojnë veçanërisht që vetëm ata që janë të autorizuar për të hyrë në të dhënat personale mund të kenë akses në të dhëna të tilla.

## **Neni 20**

### **Transmetimet e mëtejshme**

Çdo transmetim i mëtejshëm, duke përfshirë organet dhe agjencitë e Bashkimit Evropian, Shtetet Anëtare, vendet e treta dhe organizatat ndërkombëtare, do të marrë autorizimin paraprak të qartë nga Pala transmetuese, në terma specifike ose të përgjithshëm. Një pëlqim i tillë mund të jepet vetëm kur lejohet sipas kuadrit ligjor në fuqi të Palës transmetuese.

## **Neni 21**

### **Përgjegjësia për përpunimin e paautorizuar, të pasaktë ose të gabuar të të dhënave**



1. Çdo Palë do të jetë përgjegjëse, në përputhje me kuadrin e saj ligjor përkatës, për çdo dëm që i shkaktohet një individit për shkak të përpunimit të paautorizuar, të pasaktë ose të gabuar të të dhënave të kryera prej saj.
2. Asnjëra palë nuk mund të pretendojë në ndonjë proces të ngritur kundër saj se Pala tjetër ka transmetuar informacion të pasaktë. Nëse një Palë është e detyruar të paguajë shumat e dhëna si kompensim për dëmet ndaj një pale të dëmtuar, dhe dëmet janë për shkak të dështimit të Palës tjetër për të përmbushur detyrimet e saj ligjore për të transmetuar informacion dhe të dhëna të sakta, kjo e fundit është e detyruar të paguajë, sipas kërkesës, këto shuma. Në rast se nuk mund të arrihet marrëveshje për përcaktimin dhe kompensimin e dëmeve ndërmjet Palëve, çështja do të zgjidhet me konsultime të kryera në përputhje me nenin 22.
3. Palët nuk do t'i kërkojnë njëra-tjetrës të paguajnë për dëmet ndëshkuese ose jokompensuese sipas paragrafit 2 të këtij neni.

## **Kapitulli V**

### **Dispozitat përfundimtare**

#### **Neni 22**

##### **Konsultimet**

Palët do të konsultohen me njëra-tjetrën në lidhje me çdo çështje që mund të çojë në interpretime të ndryshme të kësaj Marrëveshjeje Pune.

#### **Neni 23**

##### **Shpenzimet**

Përveç nëse parashikohet ndryshe në këtë Marrëveshje Pune, Palët do të përballojnë shpenzimet e tyre që lindin gjatë zbatimit të kësaj Marrëveshjeje Pune.

#### **Neni 24**

##### **Amendimet**

Kjo Marrëveshje Pune mund të ndryshohet me shkrim në çdo kohë me pëlqim të ndërsjellë ndërmjet Palëve.

#### **Neni 25**

#### **Ndërprerja e Marrëveshjes së Punës**

- (1) Kjo Marrëveshje Pune mund të përfundojë me shkrim nga secila Palë me njoftim tre muaj më parë.
- (2) Në rast të përfundimit, Palët do të arrijnë marrëveshje për përdorimin dhe ruajtjen e vazhdueshme të informacionit që tashmë është komunikuar ndërmjet tyre.
- (3) Pa cenuar paragrafin 1, efektet juridike të kësaj Marrëveshjeje Pune do të mbeten në fuqi.

#### **Neni 26**

#### **Hyrja në fuqi**

Kjo Marrëveshje Pune do të hyjë në fuqi në datën e nënshkrimit të saj.

Bërë në Luksemburg më 29 qershor 2023 në dy kopje origjinale në gjuhën Angleze dhe Shqipe, të gjitha tekstet janë njëlloj autentike.

**Për ZPPE,**

**Laura Codruța KÖVESI**  
Kryeprokuror Evropian

**Për SPAK,**

**Altin Dumani**  
Drejtues i Prokurorisë së Posaçme